



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK**

VENDIM

Nr. 11, datë 09.04.2019

MBI

**“SHPALLJEN E ZGJEDHJEVE TË REJA, PËR 1 VËND VAKANT, PËR ANËTAR
TË SENATIT AKADEMIK, PËRFAQËSUES NGA FAKULTETI I ARTEVE TË
BUKURA, KATEGORIA PEDAGOG, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, në mbledhjen e datës 09.04.2019, mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Senatit Akademik nr. 4, datë 23.01.2019 “Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ), në Universitetin e Arteve”; Rregulloren e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me nr. 2459/1 prot., datë 15.03.2016 “Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe duke marrë në konsideratë se Prof. Fatmir Miziri, përfaqësues i Fakultetit të Arteve të Bukura në Senatin Akademik, ka mbushur moshën e pensionit dhe për këtë arsye,

V E N D O S I:

1. Shpalljen e zgjedhjeve të reja për 1 (një) vend vakant, për anëtar të Senatit Akademik, përfaqësues nga Fakulteti i Arteve të Bukura, kategoria pedagog, në Universitetin e Arteve.
2. Ngarkohet Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ) në Universitetin e Arteve, i zgjedhur me Vendimin e Senatit Akademik nr. 4, datë 23.01.2019 “Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ), në Universitetin e Arteve”, të marrin masat e nevojshme për miradministrimin e procesit zgjedhor në UART.
3. Ngarkohet Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ), që brenda 30 ditëve kalendarike, të ketë përfunduar procesi zgjedhor për 1 vende vakant, anëtar Senatit Akademik, përfaqësues nga Fakulteti i Arteve të Bukura, kategoria pedagog.
4. Ngarkohet Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ), që pas mbarimit të procesit zgjedhor, vendimin e shpalljes së fituesit, për anëtar të Senatit Akademik, përfaqësues nga Fakulteti i Arteve të Bukura, kategoria pedagog, ta dërgojë pranë Senatit Akademik.
5. Ky vendim ti dërgohet Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ).

